



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 7029 Prot.

Vau Dejës me 09/11 /2023

PROJEKT VENDIM

PËR:

"Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Besmir Mhill Kapaj"

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 49, pika 1, nenit 54, germa j, komisioni i mandateve i Këshillit Bashkiak Vau Dejës propozon të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Z. **Besmir Mhill Kapaj** propozuar nga subjekti politik, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, si pasojë e vakancës së krijuar nga Z. **Sander Nikolli**.

KRYETARI KËSHILLIT

Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**


(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

RELACION

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si pasojë e vakances së krijuar nga ish anëtari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Z. Sander Nikolli, neni 49 pika 4 germa b, dhe në bazë të nenit 49 pika 1, si dhe në vendimin nr.804 datë 20.10.2023 të KQZ Tiranë për plotesimin e vakances në Këshillin Bashkiak Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumëemërore e partisë Socialdemokrate të Shqipërisë z.Besmir Kapaj, i propozojmë Këshillit Bashkiak Vau Dejës që në mbledhjen e rradhës së muajit Nëntorë, të miratojë mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z. Besmir Mhill Kapaj.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 30.10.2023
Nr. Prot 7365

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË VAU DEJËS

Rruga "Qafa e Gurit", Vau Dejës

Për Dijeni: Partisë Socialdemokrate

Rruga "Skëndërbej", Tiranë

Z. Besmir Mhill Kapaj

Toplan, Vau Dejës

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

I nderuar Z. Kapaj,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 20.10.2023, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau Dejës, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, z. Besmir Mhill Kapaj.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 804 datë 20.10.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

Ylli MERKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.10.2023

Nr: 804

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VAU DEJËS, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE TË "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", Z. BESMIR MHILL KAPAJ

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 5646 prot., datë 14.9.2023, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Sander Ndue Nikolli, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore të "Partisë Socialdemokrate", për Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 11, z. Besmir Mhill Kapaj.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve

Data: 20.10.2023 Nr: 804
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës me kandidatin nga lista shumemërore të "Partisë Socialdemokrate", z. Besmir Mhill Kapaj"

të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit "Partia Socialdemokrate", ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 25 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Besmir Mhill Kapaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Besmir Mhill Kapaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10249/1 prot., datë 10.10.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Besmir Mhill Kapaj, në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Besmir Mhill Kapaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Besmir Mhill Kapaj, në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 20.10.2023 Nr: 804
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës me kandidatin nga lista shumëmemërore të "Partisë Socialdemokrate", z. Besmir Mhill Kapaj"

VENDOS:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore të "Partisë Socialdemokrate", z. Besmir Mhill Kapaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Ilirjan CELIBASHI

